



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 06/L-124**

**PËR SHËRBIM NË FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës,**

Në mbështetje të Nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR SHËRBIM NË FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Ky ligj rregullon kushtet e përgjithshme të shërbimit në Forcën e Sigurisë të Kosovës.

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

Ky ligj zbatohet për Forcën e Sigurisë së Kosovës, përfshirë pjesëtarët aktivë, rezervë, kadetët, rekrutët dhe personelin civil të saj.

**Neni 3**  
**Përkufizimet**

1. Për zbatim të këtij ligji, shprehjet dhe termet e përdorura në këtë ligj kanë kuptimet si vijon:

1.1. **FSK-** Forca e Sigurisë së Kosovës;

- 1.2. **Qeveria** – Qeveria e Republikës së Kosovës;
- 1.3. **Ministri** - Ministri i Mbrojtjes;
- 1.4. **Ministria** - Ministria e Mbrojtjes;
- 1.5. **Komandanti i FSK** - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës;
- 1.6. **Pjesëtar i FSK-së** - është shtetasi i Republikës së Kosovës, që shërben në Forcën e Sigurisë së Kosovës, nën betimin ushtarak dhe mban uniformën me simbolet përkatëse;
- 1.7. **Pjesëtar aktiv i FSK-së** - është shtetasi i Republikës së Kosovës, i cili shërben në komponentin aktiv të FSK-së, si oficer, nënoficer apo ushtar;
- 1.8. **Pjesëtar rezervë i FSK-së** - është shtetasi i Republikës së Kosovës, puna dytësore e të cilit është shërbimi në komponentin rezervë të FSK-së, si oficer, nënoficer, ushtar rezervë. Gjatë kohës kur angazhohet në shërbim, pjesëtari rezervë është pjesëtar aktiv i FSK-së;
- 1.9. **Personeli civil në FSK** - janë punonjësit civilë që punojnë në FSK sipas ligjit të punës apo ligjit për shërbimin civil;
- 1.10. **Personeli i FSK** - përfshin pjesëtarët aktivë, rezervë, kadetët, si dhe personelin civil të FSK-së;
- 1.11. **Bordi Disiplinor i FSK-së** – autoriteti kompetent, i cili shqyrton dhe vendos për të gjitha shkeljet e rënda të pjesëtarëve të FSK-së;
- 1.12. **Shtabi i Përgjithshëm** - përbën nivelin më të lartë në strukturën organizative ushtarake në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe udhëhiqet nga Komandanti i FSK-së;
- 1.13. **Komisionari Parlamentar për FKS-në** - është organ i pavarur që zgjidhet nga Kuvendi i Kosovës, që mbron të drejtat e personalit të FSK-së. Funkcionimi dhe kompetencat e këtij institucioni rregullohen me ligj të veçantë;
- 1.14. **Dezertim** - është akt i largimit të qëllimshëm dhe jo ligjor nga shërbimi gjatë gjendjes së jashtëzakonshme.

#### **Neni 4** **Shërbimi në FSK**

Shërbimi në FSK përcakton shërbimin e pjesëtarit të FSK-së sipas kushteve dhe rregullave të përcaktuara në këtë ligj në përmbushje të kompetencave dhe detyrave kushtetuese dhe ligjore.

## **Neni 5**

### **Parimet e shërbimit**

1. Shërbimi në FSK bazohet në këto parime themelore:

- 1.1. parimi i ligjshmërisë;
- 1.2. parimi i profesionalizmit;
- 1.3. parimi i zinxhirit të unifikuar komandues;
- 1.4. parimi i jodiskriminimit;
- 1.5. parimi i transparencës dhe llogaridhënies;
- 1.6. parimi i meritokracisë;
- 1.7. parimi i kujdesit ndaj vartësit;
- 1.8. parimi “esprit de corps”.

## **Neni 6**

### **Kriteret e përgjithshme për shërbim**

1. Shtetasi i Republikës së Kosovës që dëshiron të aplikojë në FSK, duhet të plotësoj kushtet e përcaktuara me këtë ligj dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

2. Kriteret e përgjithshme që duhet të plotësohen për t’u pranuar si pjesëtar i FSK-së, janë:

- 2.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- 2.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- 2.3. të përmbushë nivelin e kërkuar arsimor;
- 2.4. të zotërojë aftësitë e nevojshme shëndetësore e fizike për vendin e shërbimit;
- 2.5. të mos jetë i dënuar për veprë penale, me vendim të formës së prerë.

3. Moshë minimale për tu rekrutuar në Forcën e Sigurisë së Kosovës është tetëmbëdhjetë (18) vjeç.

4. Moshë me e lartë për tu rekrutuar në FSK është:

- 4.1. tridhjetëvjeçar (30) për oficer, me kualifikime të veçanta specialistike;

4.2. njëzetënjëvjeçar (21) për kadetë;

4.3. njëzetetrevjeçar (23) për ushtar.

5. Shtetasit e Republikës së Kosovës mund të pranohen në Forcën e Sigurisë së Kosovës pasi të kenë plotësuar kërkesat dhe kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes.

6. Pranimi bazohet në gjendjen shëndetësore dhe fizike dhe sipas nevojave e prioriteteve të FSK-së dhe pas përfundimit me sukses të procedurës së miratuar për rastet në të cilat kërkohet verifikimi i kontrollit të sigurisë, respektivisht pastërtisë së figurës, sipas legjislacionit përkatës në fuqi dhe akteve të brendshme nënligjore të ministrisë.

7. Pranimi në FSK konfirmohet pas përfundimit të trajnimit bazik, gjatë së cilës kohë, kandidatët do të cilësohen si rekrutë (OR1). Rekrutët e FSK-së kanë të drejtë të tërhiqen/ndërpresin trajnimin pa ndonjë detyrim tjetër, nëse këtë e bëjnë gjatë trajnimit bazik.

8. Pranimi në Forcën e Sigurisë së Kosovës bëhet si kadetë për kategorinë e oficerëve dhe si rekrutë për kategorinë e ushtarëve.

9. Pas kryerjes së studimeve akademike ushtarake, kadetët marrin gradën më të ulët të oficerit, ndërsa rekrutët, pas përfundimit të trajnimit bazik, marrin gradën e ushtarit.

10. Kriteret dhe kushtet e tjera për pranim në Forcën e Sigurisë së Kosovës, përveç se parashikohen në këtë ligj, përcaktohen me akt të veçantë nënligjor të nxjerr nga Ministri.

## **Neni 7 Betimi**

1. Ditën e emërimit si oficer dhe nënoficer aktiv dhe rezervë i Forcës së Sigurisë së Kosovës, pjesëtari bën betimin.

2. Deklarata e betimit është:

*“Betohe më solemnisht se do të jem i përkushtuar dhe do t’i qëndroj plotësisht besnik Republikës së Kosovës, se do t’iu bindem urdhrave të Presidentit të Republikës së Kosovës dhe eprorëve të mi në pajtim me ligjin, dhe se do t’i kryej detyrat e mia me zell, nder dhe dinjitet. Betohe më solemnisht se do të zbatoj Kushtetutën e Republikës së Kosovës, do t’i shërbej popullit dhe Atdheut tim, dhe për mbrojtjen e tyre, nuk do të kursej as jetën time! Betohe më!”*

## **Neni 8**

### **Kohëzgjatja e shërbimit**

1. Kohëzgjatja e shërbimit në FSK është e ndarë në shërbim afatshkurtër dhe afatgjatë, e përcaktuar me kontratë të shërbimit, sipas rregullave dhe kushteve të parapara me rregullore të vecantë të nxjerrë nga Ministri.
2. Pjesëtari rezervë gjatë kohës së angazhimit i nënshtrohet rregullave dhe kushteve të shërbimit sikurse pjesëtari aktiv.

## **Neni 9**

### **Zhvillimi i karrierës**

1. Me pranimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës, pjesëtari aktiv gëzon të drejtën e gradimit dhe zhvillimit të karrierës.
2. Zhvillimi i karrierës së pjesëtarit të FSK-së përcaktohet me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

## **Neni 10**

### **Vlerësimet vjetore**

1. Të gjithë pjesëtarët e FSK-së i nënshtrohen vlerësimit vjetor.
2. Kriteret dhe procedurat e vlerësimit vjetor përcaktohen me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

## **Neni 11**

### **Medaljet dhe mirënjohjet**

1. Shërbimi meritor dhe veprat e trimërisë nga ana e pjesëtarëve të FSK-së, njihen nëpërmjet medaljeve, lëvdatave, shpërblimeve dhe mirënjohjeve.
2. Presidenti i Republikës së Kosovës, për pjesëtarët e FSK-së, jep dekorata në pajtim me legjislacionin në fuqi.
3. Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ministri dhe Komandanti i FSK-së, janë të autorizuar t'u japin medalje, lëvdata, shpërblime dhe mirënjohje pjesëtarëve të FSK-së, si dhe personave fizikë dhe juridikë të vendit dhe të huaj, që e kanë dalluar vetën me meritat e tyre për Forcën e Sigurisë së Kosovës.
4. Në zbatim të paragrafit 3. të këtij neni, Ministri nxjerr akt të veçantë nënligjor.

**Neni 12**  
**Të dhënat personale dhe dosja e personelit**

1. Pas pranimit në Forcën e Sigurisë së Kosovës, secilit pjesëtar i caktohet numri unik personal, i cili përbën bazën për të gjitha shënimet personale dhe ato të karrierës.
2. Secilit pjesëtar aktiv dhe rezervë të FSK-së, i lëshohet kartela personale e identifikimit. Kartela duhet të mbahet gjatë tërë kohës derisa pjesëtari është në detyrë.
3. Ministria dhe Shtabi i Përgjithshëm i FSK-së janë përgjegjëse për zhvillimin e një sistemi gjithëpërfshirës për kontrollimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e dosjeve të personelit të FSK-së, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.
4. Rregullat e hollësishme për të dhënat personale dhe dosjen e personelit përcaktohet me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

**Neni 13**  
**Orari i punës**

1. Kohëzgjatja e rregullt e orarit të punës për në FSK, është e njëjtë me atë të administratës publike.
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1. i këtij neni, orari i punës për FSK mund të zgjatet për nevoja të shërbimit të brendshëm, gatishmërisë, stërvitjeve dhe operacioneve.
3. Në zbatim të këtij neni, orari i punës në FSK përcaktohet me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

**Neni 14**  
**Pagat, shtesat mbi pagë dhe kompensimet tjera**

1. Të drejtën në pagë, shtesat mbi pagë dhe llojet tjera të kompensimit e kanë të gjithë pjesëtarët e FSK-së.
2. Shtesat mbi pagë dhe kompensimet tjera, bazohen në detyrat e rrezikshme, punën jashtë orarit, orarin e punës me ndërrime, punën gjatë festave ose ditëve të tjera që janë ditë pushimi, caktimin në punë të veçanta dhe për performancë/arritje të jashtëzakonshme.
3. Pagat, shtesat mbi pagë dhe kompensimet tjera, përcaktohen dhe paguhen në përputhje me dispozitat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Qeveria.

## **Neni 15**

### **Pushimet dhe ngjarjet përkujtimore**

1. Pjesëtari aktiv i FSK-së gëzon të drejtën e të gjitha pushimeve të parapara me legjislacionin në fuqi.
2. Përcaktimi i llojeve, kriterëve, kohëzgjatjes dhe procedurave për dhënien dhe shfrytëzimin e pushimeve në FSK rregullohen me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministri.
3. Në pajtim me kërkesat për mbulueshmërinë me personel, siç përcaktohet me detyrat dhe përgjegjësitë e FSK-së, FSK-ja mund të shënojë edhe ditët dhe festat e shënuara kombëtare apo shtetërore dhe ngjarjeve tjera përkujtimore që u përgjigjen datave që kanë të bëjnë me krijimin dhe aktivitetet e saj.
4. Të gjitha pushimet e përcaktuara sipas këtij neni mund të anulohen, shtyhen ose ndërpriten për të përmbushur kërkesat operative të paparashikueshme apo ato të caktuara brenda një kohe të shkurtër.

## **Neni 16**

### **Ushqimi, transporti dhe akomodimi**

1. Pjesëtari aktiv i FSK-së ka të drejtë për së paku një racion të ushqimit, gjatë secilit orar të plotë të punës (e përcaktuar si çdo periudhë e qëndrimit të vazhdueshëm në detyrë për më shumë se gjashtë (6) orë në çdo dymbëdhjetë (12) orë).
2. Forca e Sigurisë së Kosovës, mund të ofrojë transport të rregullt ndërurban për pjesëtarët aktivë të saj.
3. Gjatë shërbimit, pjesëtari aktiv i FSK-së ka të drejtë të shfrytëzojë akomodimin, qoftë brenda vendit të shërbimit, ose brenda një largësie të arsyeshme nga vendi i shërbimit, në rast se FSK nuk ofron transportin për të.
4. Rregullat për ushqimin, transportin dhe akomodimin, përcaktohen me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

## **Neni 17**

### **Kujdesi shëndetësor**

1. Forca e Sigurisë së Kosovës ofron shërbim shëndetësor për të gjithë personelin e saj.
2. Forca e Sigurisë së Kosovës ofron kujdes shëndetësor për anëtarët e ngushtë të familjes së pjesëtarit, përderisa ai/ajo gjendet në mision jashtë vendit.

3. Sipas paragrafëve 1. dhe 2. të këtij neni, kujdesi shëndetësor primar duhet të ofrohet, aty ku është e mundshme, brenda burimeve vetanake të FSK-së. Në rastet kur kjo nuk është e mundshme, ose kur kërkesa është jashtë fushës, të cilën e mbulon Shërbimi Mjekësor i FSK-së, pjesëtarët duhet të dërgohen në sistemin e kujdesit shëndetësor kombëtar.

4. Kur kujdesi shëndetësor kombëtar nuk ofron shërbimin përkatës shëndetësor, trajtimi mjekësor i pjesëtari të FSK-së bëhet jashtë vendit.

5. Organizmi dhe funksionimi i shërbimit mjekësor, rregullohet me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

### **Neni 18**

#### **Masat mbrojtëse dhe siguria në punë**

1. Masat mbrojtëse për personelin e FSK-së përcaktohen sipas shkallës së rrezikshmërisë gjatë shërbimit të rregullt, stërvitjeve dhe operacioneve.

2. Masat mbrojtëse dhe siguria në punë përcaktohen me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

### **Neni 19**

#### **Ndërprerja e shërbimit**

1. Shërbimi në Forcën e Sigurisë së Kosovës mund të ndërpritet në mënyrë vullnetare dhe të detyrueshme.

2. Të gjitha ndërprerjet e shërbimit, përveç atyre që bëhen për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, përcaktohen me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

### **Neni 20**

#### **Ndërprerja vullnetare e shërbimit**

1. Të gjithë pjesëtarët e FSK-së kanë të drejtë të ndërpresin vullnetarisht shërbimin e tyre, pas lajmërimit paraprak në afat prej nëntëdhjetë (90) ditë pune, përveç rasteve specifike, me miratim paraprak nga Komandanti i FSK-së.

2. Paragrafi 1. i këtij neni nuk zbatohet për personelin e FSK-së, të cilët kanë marrë pjesë në shkollime dhe trajnime të financuara dhe që janë të obliguar të shërbejnë për një periudhë kohore të paracaktuar, me qëllim të kthimit të investimit të bërë nga FSK. Ky rregull zbatohet edhe për personelin e FSK-së, në ushtrime/stërvitje dhe operacione.



## **Neni 21**

### **Ndërprerja e detyrueshme e shërbimit**

1. Shërbimi i pjesëtarit të FSK-së përfundon në mënyrë të detyrueshme nën rrethanat e poshtëshënuara.

1.1. arrin moshën për pension;

1.2. ka dhënë shënime të rrejshme gjatë procesit të rekrutimit;

1.3. dështon në plotësimin e standardeve të kërkuara të shërbimit;

1.4. dështon në mbajtjen e gjendjes të kërkuar fizike ose mjekësore, përjashtimisht rasteve që rezultojnë si pasojë nga shërbimi në FSK dhe ka mundësi të ri-caktimit;

1.5. është dënuar për vepër penale me burg efektiv mbi gjashtë (6) muaj me vendim të formës së prerë;

1.6. me vendim të Bordit Disiplinor të FSK-së;

1.7. ka marrë post politik ose është angazhuar në cfardo mënyrë në veprimtarinë politike partiake.

## **Neni 22**

### **Fitimi i statusit të pjesëtarit të FSK-së**

1. Shtetasi i Republikës së Kosovës, nga dita e fillimit të shërbimit në Forcën e Sigurisë së Kosovës, fiton statusin e pjesëtarit të FSK-së dhe gëzon të gjitha drejtat dhe përmbush detyrimet e përcaktuara në këtë ligj dhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore.

2. Statusin e pjesëtarit të FSK-së e gëzojnë:

2.1. pjesëtarët e shërbimit aktiv;

2.2. pjesëtarët e shërbimit rezervë;

2.3. kadetët.

## **Neni 23**

### **Ruajtja e statusit të pjesëtarit të Forcës së Sigurisë së Kosovës**

Në rastet kur pjesëtari i FSK-së kapet rob apo merret peng, në territorin e Republikës së Kosovës ose në territorin e një shteti tjetër, ruan të drejtat dhe obligimet që i njeh statusi i pjesëtarit të FSK-së.

**Neni 24**  
**Humbja e statusit të pjesëtarit të Forcës së Sigurisë së Kosovës**

1. Statusi i pjesëtarit të FSK-së humbet në rastet kur pjesëtari:

1.1. dënohet me burgim nga gjykata me vendim të formës së prerë për vepra penale të kryera me dashje që rezulton me ndërprerje të shërbimit;

1.2. njëanshëm ndërpre shërbimin në FSK pa shkaqe ligjore;

1.3. dezerton.

**Neni 25**  
**Të drejtat e pjesëtarit të Forcës së Sigurisë së Kosovës**

1. Pjesëtari i FSK-së, gëzon trajtim të drejtë dhe të barabartë, çmohet dhe respektohet si individ, mbështetet dhe shpërblehet sipas rregullave dhe kushteve të shërbimit.

2. Të drejtat e pjesëtarit të FSK-së, në veçanti përfshijnë:

2.1. mbrojtje shtetërore në kryerjen e detyrave të ngarkuara;

2.2. mbajtje dhe përdorim të armës në përputhje me rregullat e përcaktuara me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

2.3. mundësi në zhvillimin e plotë të karrierës për të realizuar plotësisht potencialin e tij përmes procedurave të emërimit, gradimit dhe zhvillimit në bazë të meritokracisë dhe në pajtim me procedurat e përcaktuara me aktet ligjore dhe nënligjore;

2.4. të drejtën që në mënyrë individuale të paraqesin sipas rastit kërkesa ose ankesa për veprime të paligjshme të eprorëve në rastet kur u cenohen të drejtat e tyre, si dhe shqyrtimin e tyre nga ana e zinxhirit komandues në mënyrë të drejtë dhe pa paragjykim për perspektivat aktuale ose të ardhshme të karrierës;

2.5. të trajnohet, të kualifikohet dhe të ndjekë studimet në institucionet arsimore, ushtarake ose civile, brenda dhe jashtë vendit, vetëm kur i jepet leje, sipas legjislacionit në fuqi;

2.6. sipas nevojave për përfaqësim të FSK-së, pjesëtarët e FSK-së përzgjidhen për të shërbyer si atashe të mbrojtjes në përfaqësitë diplomatike jashtë vendit, oficer/nënoficer ndërlidhës në organizata dhe institucione ndërkombëtare të sigurisë dhe mbrojtjes, sipas legjislacionit përkatës në fuqi dhe me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria;

2.7. sipas kërkesave dhe bazuar në marrëveshjet bilaterale, pjesëtarët e FSK-së dërgohen për të shërbyer jashtë vendit, me qëllim të shkëmbimit të përvojave.

## **Neni 26**

### **Obligimet e pjesëtarit të Forcës së Sigurisë së Kosovës**

#### 1. Pjesëtari i FSK-së është i obliguar që:

1.1. të njohë, të respektojë dhe të veprojë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin në fuqi;

1.2. të kryejë të gjitha detyrat me nder, paanshmëri dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi;

1.3. të ruajë nderin e dinjitetin e ushtarakut;

1.4. të shërbejë kudo që kërkojnë interesat institucionale dhe shtetërore;

1.5. të zbatoj urdhërat e zinxhirit komandues;

1.6. të zbatojë të gjitha urdhrat e ligjshëm që jepen për qëllime shërbimi edhe në rast se paraqet rrezik për jetën e tij;

1.7. të mos zbatojë urdhrat që bien në kundërshtim me ligjin dhe të njoftojë urdhërdhënësin dhe eprorin e vet;

1.8. të jetë i gatshëm dhe i disiplinuar për kryerjen e detyrës;

1.9. të mbrojë të gjitha informatat, në çfarëdo forme, si dhe pajisjet e marra ose që i janë dhënë gjatë detyrës në përputhje me legjislacionin në fuqi;

1.10. të respektojë orarin e punës;

1.11. të mbajë uniformën dhe simbolet e FSK-së në përputhje me legjislacionin përkatës;

1.12. të veprojë me integritet gjatë gjithë kohës dhe të mos e keqpërdorë pozitën zyrtare ose informatat zyrtare për përfitim personal ose të tjerëve;

1.13. të mos kërkojë ose pranojë asnjë përfitim material, për kryerjen e detyrave, me përjashtim të pagës dhe të përfitimeve të tjera, të përcaktuara me ligj e akte të tjera nënligjore;

1.14. mosdhënie e deklaratave publike përmes medimeve dhe formave tjera të komunikimit publik që kanë të bëjnë me FSK-në, pjesëtarët ose aktivitetet e saj pa pëlqimin e zinxhirit komandues;

1.15. të shmangë çfarëdo aktiviteti që mund të përbëjë konflikt të interesit ndërmjet detyrave zyrtare dhe private;

1.16. të rrisë aftësitë profesionale dhe të marrë pjesë në veprimtari trajnuese;

1.17. të zbatojë standardet e mirësjelljes dhe ruajtjes së integritetit.

2. Pjesëtarët e FSK-së nuk mund të angazhohen në punësim dytësor, përveç me miratimin paraprak të autoritetit kompetent dhe sipas rregullave të përcaktuara me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

3. Shkelja e obligimeve të përcaktuara në këtë nen trajtohet në përputhje me dispozitat e Kodit Disiplinor të FSK-së dhe legjislacionin në fuqi.

### **Neni 27** **Shqyrtimi i ankesave**

1. Çdo pjesëtar i FSK-së ka të drejtë të parashtojë ankesë për çfarëdo shkelje të pretenduar të të drejtave të tij lidhur me shërbimin në FSK.

2. Rregullat dhe procedurat për parashtrimin dhe shqyrtimin e ankesave përcaktohen me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

3. Përfundimisht paragrafit 2. të këtij neni, pjesëtari i FSK-së mund t'i drejtohet komisionarit përkatës parlamentar për FSK-në, sipas ligjit të veçantë për komisionarin.

### **Neni 28** **Kodi i Etikës dhe Kodi Disiplinor**

Kodi i Etikës dhe Kodi Disiplinor, me të cilat përcaktohen standardet e sjelljes dhe procedurat disiplinore në FSK, përcaktohen me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

### **Neni 29** **E drejta në pension**

E drejta në pension për pjesëtarin e FSK-së dhe familjarët e tij, mosha, llojet, kriteret dhe kushtet e përfitimit të pensionit përcaktohen me ligj të veçantë.

### **Neni 30** **Mbrojtja e veçantë ligjore**

1. Jeta, figura dhe dinjiteti i pjesëtarit dhe familjes së tij janë të paprekshme dhe mbrohen me ligj.

2. Gjatë kryerjes së detyrës dhe për shkak të saj, pjesëtarit aktiv dhe në rezervë i garantohet mbrojtja e veçantë ligjore.

3. Pjesëtari i FSK-së nuk mund të arrestohet nga Policia e Kosovës, brenda hapësirave dhe zonave të FSK-së.

4. Në rastet kur pjesëtari i FSK-së ndalohet dhe arrestohet nga Policia e Kosovës, jashtë hapësirave dhe zonave të FSK-së, njoftohet Policia e FSK-së”.

5. Në rastet kur për shkak të detyrës që kryen ose ka kryer, rrezikohet familja ose pasuria e pjesëtarit të FSK-së nga veprime të paligjshme, atij i garantohet mbrojtje dhe mbështetje e veçantë nga struktura shtetërore.

6. Çdo veprim që drejtohet kundër jetës, figurës dhe dinjitetit të pjesëtarit të FSK-së dhe familjes së tij, dënohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### **Neni 31**

#### **Protokolli zyrtar**

1. Veprimtaritë përkujtimore, pritja e personaliteteve të vendit dhe të huaja, zhvillohen me protokoll zyrtar të FSK-së.

2. Rregullat e protokollit zyrtar të FSK-së përcaktohen me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

### **Neni 32**

#### **Ceremonitë zyrtare**

1. Ceremonia e varrimit të pjesëtarit dhe pensionistit të FSK-së, kryhet me ceremoni zyrtare të FSK-së. Shpenzimet e varrimit të pjesëtarit të FSK-së mbulohen nga Ministria.

2. Rregullat e ceremonive zyrtare të FSK-së, përcaktohen me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

### **Neni 33**

#### **Nxjerrja e akteve nënligjore**

1. Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj nxirren në afat prej më së largu një (1) vit nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Aktet nënligjore që janë në fuqi vazhdojnë të zbatohen, deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore, me kusht që të mos jenë në kundërshtim me këtë ligj.

**Neni 34**  
**Dispozitat e kalimtare**

Të gjitha ndryshimet e parapara me këtë ligj do të bëhen konform fazave të përcaktuara në rekomandimet e rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë dhe të detajuara në planin gjithëpërfshirës të tranzicionit.

**Neni 35**  
**Shfuqizimi**

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen:

1.1. Ligji nr. 03/L-082 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 32 / 15 qershor 2008);

1.2. Neni 21 (Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-082 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës) të Ligjit nr. 04/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës (Gazeta Zyrtare / nr. 25 / 07 shtator 2012).

**Neni 36**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 06/L-124**  
**14 dhjetor 2018**

**Kadri Veseli**

---

**Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës**